

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 361/ 2021, 27-12-2021****Parashikimi** nga 27-12-2021, ora 12:00 deri më 28-12-2021, ora 23:59.**PARASHIKIM I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Sipas llogaritjeve të IGJEO, ditën e sotme (e hënë, dt.27) dhe ditën e nesërme (e martë dt.28) pritet një rritje e prurjeve në lumenjtë Drin-Buna, Vjosa dhe Liqenin e Shkodrës. Në qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në po këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së kanalizimeve. Pas ditës së nesërme me dobësimin e reshjeve prurjet pritet të pësojnë rënie. Ky informacion do të përditësohet nga IGJEO sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e përmbytjeve.

PARASHIKIMI METEO
-----**RESHJET**

Sot pasdite (e hënë dt.27) priten reshje mesatare në qarqet Vlorë, Gjirokastrë dhe lokalisht mesatare në qarqet e tjerë. Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata në qarqet Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë. Nesër (e martë dt.28) priten reshje të dobëta në të gjithë qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

TEMPERATURAT

Nesër (e martë dt.28) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 11 / 15 °C

në vendet e ulëta: 9 / 14 °C

në vendet malore: 4 / 8 °C

ERA

Sot pasdite (e hënë dt.27) dhe nesër (e martë dt.28) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: *Elsuida Hoxha*Koordinator: *Alban Doko* (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)

Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 361/ 2021, 27-12-2021


Parashikimi nga 27-12-2021, ora 12:00 deri më 28-12-2021, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
KUKËS	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
DIBËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
LEZHË	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
DURRËS	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
TIRANË	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
ELBASAN	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
FIER	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
BERAT	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
KORÇË	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	mesatare					

LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 27 – 28.

SIMBOLE

	Shtërngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke